



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 694 Prot.

Tiranë, më 29.06 2016

VENDIM Nr. 65, datë 28.06.2016

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8 të datës 28.06.2016, pasi shqyrtoi *Projektin e ndërhyrjeve përforcuese në themele, në objektin e Trapezarisë në Parkun Arkeologjik të Apolonisë*, paraqitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin e ndërhyrjeve përforcuese në themele, në objektin e Trapezarisë në Parkun Arkeologjik të Apolonisë*, paraqitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.
2. Punimet për kryerjen e gërmimeve për përforcimin e themeleve në objektin e Trapezarisë, në Parkun Arkeologjik të Apolonisë të realizohen nën mbikëqyrjen e specialistit arkeolog të Parkut të Apolonisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO